



Projekti “JOINt approAch to Blue circuLar Economy – for Adriatic and Ionian Region “  
(JOINABLE)

**Qëllimi dhe një përshkrim i projektit**

Ky projekt përfaqëson një përpjekje kolektive të nëntë partnerëve nga gjashtë vende (Italia, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Greqia), që synon të rrisë zhvillimin e një ekonomie blu rrethore që bazohet në mbetjet plastike të mbledhura nga mjediset ujore.

Projekti JOINABLE bashkë-financohet nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet programit Interreg IPA ADRION dhe zbatohet nga konsortiumi si më poshtë vijon:

	<b>Emri I partnerit</b>	<b>Shteti</b>	<b>Roli ne projekt</b>
1	Bashkia Punat	Kroaci	Koordinator
2	Sensum Ltd.	Kroaci	Partner
3	Agjencia për Inovacionin në Sektorët e Agroushqimit dhe Peshkimit	Itali	Partner
4	Venice Lagoon Plastic Free	Itali	Partner
5	Instituti i Zhvillimit të Sipërmarrjes	Greqi	Partner
6	Universiteti i Malit të Zi, Fakulteti i Studimeve Detare Kotorr	Mali I Zi	Partner
7	Universiteti i Shkencave të Informacionit dhe Teknologjisë, Ohër	Maqedoni	Partner
8	Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit	Shqipëri	Partner
9	Bashkia Divjakë	Shqipëri	Partner

Ky projekt synon të shqyrtojë situatën aktuale në lidhje me mbetjet plastike, duke përfshirë kuadrin ligjor, në çdo vend pjesëmarrës. Ai do të përfshijë edukimin e trajnerëve për përdorimin e mjeteve dhe spektrometrit dixhital, zhvillimin e një metodologjie për pastrimin dhe monitorimin e mbetjeve plastike



Interreg



Co-funded by  
the European Union

IPA ADRION

dhe krijimin e një sistemi që transformon mbetjet plastike në produkte të reja. Për më tepër, projekti do të ndajë njohuritë me autoritetet lokale dhe rajonale dhe do të raportojë të dhënat tek Rrjeti Evropian i Vëzhgimit dhe të Dhënave Detare (EMODnet).

Qëllimi është të zhvillohet një strategji gjithëpërfshirëse për menaxhimin e mbetjeve plastike në rajonin ADRION duke nxitur zhvillimin e ekonomisë rrethore blu. Kjo strategji do të adresojë sfidat dhe mundësitë specifike brenda rajonit, duke synuar të reduktojë ndikimin mjedisor të mbetjeve plastike duke promovuar një rritje të qëndrueshme ekonomike përmes praktikave inovative të riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve.